



Funded by  
the European Union

# Moduli 3: Mësimnxënia e individualizuar

Punëtori për zhvillimin profesional me bazë në shkollë



Përmbajtja e punëtorisë	Aktivitetet
Fjalorth	Aktiviteti i fjalorthit
Pse nxënësit nuk duhet ta përsërisin një vit	Diskutim mbi përsëritjen e vitit
Problemi me diferencimin e të nxënët duke i grupuar ose ndarë nxënësit	Diskutim mbi ndarjen dhe grupimin e nxënësve
Çfarë është diferencimi?	
Llojet e diferencimit	
Diferencimi sipas përmbajtjes	Diferencimi sipas përmbajtjes aktivitet
Diferencimi sipas procesit	Diferencimi sipas procesit aktivitet
Diferencimi sipas produktit	Diferencimi sipas procesit aktivitet
Diferencimi sipas mjedisit mësimor	Diferencimi sipas mjedisit mësimor aktivitet
Rubrika	Aktiviteti i vlerësimit me rubrikë
Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike	Aktiviteti i citimeve të nxënësve
Tejkalimi i barrierave në një shkollë me burime të pamjaftueshme	
	Aktiviteti i citimeve të nxënësve
Praktika më e mirë mbi të nxënët e diferencuar	Praktika më e mirë mbi të nxënët e diferencuar aktivitet
Të nxënët digjital	
Tekstet shkollore	Aktiviteti me tekste shkollore
	Definoni mësimdhënien dhe të nxënët e cilësisë së lartë
	Aktiviteti lidhur me vetë-studimin e shkollës.
Reflektim mbi punëtorinë	

## Objektivi i të nxënit i punëtorisë:

Të kuptohet si të diferencohet të nxënit sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit mësimor.

## Kriteret e suksesit të punëtorisë:

Pjesëmarrësit e punëtorisë do t'i identifikojnë dhe listojnë strategjitë për ta diferencuar të nxënit sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit mësimor.

Pjesëmarrësit e punëtorisë do të jenë në gjendje të vlerësojnë se sa mirë diferencohet të nxënit sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit mësimor në shkollën e tyre.

# Aktiviteti i fjalorthit

- Lexoni fjalorthin nga sllajdet ose fletushkat dhe shkruani fjalët ose konceptet edukative që nuk i keni parë më herët.
- Diskutoni tërë fjalorthin me partnerin tuaj.
- A e sfidon ndonjë nga këto terma mënyrën se si ju e mendoni mësimdhënien dhe të nxënit?

# Fjalorth

- **Vlerësimi mirënjohës** është kur një mësimitdhënës përdor shenja, nota të thjeshta ose korigjime (10/10), një vulë dhe/ose komente të shkurtra të bazuara në arritje.
- **Diferencimi i përmbajtjes** nënkupton përdorimin e formateve të ndryshme gjatë mësimitdhënies si video, tekste, ligjërata ose audio.
- **Diferencimi sipas produktit** do të thotë që mësimitdhënësit i vlerësojnë të njëjtat njohuri ose shkathtësi të secilit nxënës, por ata u ofrojnë nxënësve të tyre mënyra të ndryshme për t'i demonstruar njohuritë e tyre (p.sh. video, raport me shkrim).
- **Diferencimi sipas procesit**, do të thotë se mësimitdhënësit ua mësojnë secilit nxënës të njëjtin koncept ose shkathtësi, por ata e ndryshojnë mënyrën se si e ligjërojnë atë. Nxënësit mund të punojnë në çifte ose grupe, të përdorin teknologjinë, të përdorin objekte për t'u ndihmuar atyre që ta kuptojnë një koncept.
- **Diferencimi i mjedisit mësimor** do të thotë se mësimitdhënësi bën ndryshime ose në mjedisin fizik ose në atmosferën në të cilën punojnë nxënësit.
- **Informatat kthyesë** mund të jenë me shkrim ose me gojë. Këto janë informata që u jepen nxënësve nga mësimitdhënësi lidhur me performancën e tyre. (Notimi i nxënësve me 1,2,3,4,5 nuk është informatë kthyesë)

# Fjalorth

- **Vlerësimet formative:** përdorën për të informuar procesin e mësimdhënies dhe të nxënit. Ato i identifikojnë konceptet e gabuara, dhe boshllëqet në mësim-nxënie, dhe e përmirësojnë mësimdhënien si dhe të nxënit. *Për shembull: kuizet, reflektimet në klasë, përdorimi i pyetjeve përforcuese, anketave, punën në grupe.*
- **Vlerësimi formativ i ciklit të gjatë:** Të arriturat e nxënësve monitorohen përgjatë njësive mësimore. Cikli mund të zgjas nga 4 javë deri në 1 vit. Të dhënat përdoren për ta përafuar kurrikulën, për ta monitoruar mësimdhënien e kurrikulës dhe për t'i monitoruar të arriturat e nxënësve për një periudhë më të gjatë kohore. *Për shembull: Vlerësimi në fund të semestrit. Vlerësimi në fund të vitit.*
- **Vlerësimi formativ i ciklit të mesëm:** Ky vlerësim bëhet në fund të një faze të të nxënit.
- Kjo bëhet çdo 1 deri në 4 javë. *Për shembull: Një shkrim i vlerësuar i cili është kulmi i tre javëve të punës. Një test matematike pas dy javësh mësimi për thyesat.*
- **Vlerësimi formativ i ciklit të shkurtër:** Një fjalë tjetër për këtë është 'mësimdhënia reaguese.' Ky vlerësim bëhet gjatë një ore mësimore ose ndërmjet orëve mësimore. Mësimdhënësi reagon ndaj të dhënave të mbledhura në orën e mësimimit dhe e përshtat mësimdhënien në përputhje me rrethanat. *Për shembull: Pyetjet me shumë zgjedhje, vëzhgimi nga mësimdhënësi, kuizet, përgjigjja në një pyetje në tabela të bardha individuale ose në copëza letre.*

# Fjalorth

- **Pyetja përforcuese** është një kontroll kyç për të kuptuar në thelb një njësi mësimore që është kritike për t'u kuptuar nga nxënësit. Secili nxënës duhet të përgjigjet në pyetje brenda dy minutave. Mësimdhënësi duhet të jetë në gjendje t'i mbledhë dhe interpretojë përgjigjet nga të gjithë nxënësit brenda 30 sekondave dhe të vendosë se si të vazhdojë me njësinë mësimore.
- **Meta-njohja** ka të bëjë me mënyrat se si nxënësit e monitorojnë dhe drejtojnë me qëllim të nxënësve të tyre.
- **Vlerësimi i shokëve të klasës** është kur nxënësit e marrin përgjegjësinë për vlerësimin e punës së bashkëmoshatarëve të tyre karshi kriterëve të përcaktuar të vlerësimit.
- **Mësimdhënia reaguese**: është një mënyrë tjetër për të thënë vlerësimi formativ i ciklit të shkurtër.

# Fjalorth

- **Rubrika** është një udhëzues që përdoret për ta vlerësuar performancën, një produkt ose një projekt. Zakonisht përfshin kriteret e performancës; dhe një shkallë vlerësimi (Shkëlqyeshëm, Mirë, Kënaqshëm, Pakënaqshëm ose 1,2,3,4,5 ose A, B, C, D)
- **Vetë-vlerësimi:** është kur nxënësit vlerësojnë vetveten. Ata mund t'i vlerësojnë veprimet e tyre, qëndrimin ose performancën e tyre.
- **Nxënësit e vetë-rregulluar:** e kuptojnë dhe e kontrollojnë mjedisin e mësim-nxënies së tyre.
- Aftësitë **vetë-rregulluese** përfshijnë përcaktimin e qëllimeve, vetë-monitorimin dhe vetë-udhëzimin.
- **Këshilli i nxënësve:** është një grup i nxënësve të zgjedhur nga bashkëmoshatarët e tyre për të trajtuar çështjet që i shqetësojnë.
- **Kriteret e suksesit:** është një listë e veçorive që mësimdhënësi dëshiron që fëmijët t'i përfshijnë në punën e tyre gjatë orës së mësimi.



---

*Edukatorët duhet të jenë kampionë të çdo nxënësi që hyn në dyert e shkollës.*

Carol Ann Tomlinson

Tomlinson, C. A. (2014) *The Differentiated Classroom: Responding to the Needs of All Learners*, 2nd Edition,

Pse nxënësit nuk  
duhet ta përsërisin  
një vit



# Dëshmitë nga hulumtimi tregojnë se:

1. Efektet negative ..(të përsëritjes së vitit)...janë identifikuar vazhdimisht gjatë pesëdhjetë viteve të fundit si në Evropë ashtu edhe në Amerikën Veriore.
2. Në shumicën e rasteve, përsëritja e vitit është e dëmshme për mundësitë e nxënësit për sukses akademik.

Education Endowment Foundation (N.D.) Repeating a Year

Available from:

<https://educationendowmentfoundation.org.uk/education-evidence/teaching-learning-toolkit/repeating-a-year> (Accessed on 5 November 2021)

# Dëshmitë nga hulumtimi tregojnë se:

3. Nxënësit që e përsërisin vitin kanë më shumë gjasa që ta braktisin e shkollës para përfundimit.
4. Përsëritja e vitit ka, po ashtu, të ngjarë të shkaktojë efekte më të mëdha negative kur aplikohet në vitet e para të shkollës fillore, për nxënësit nga pakicat etnike, ose për nxënësit që janë relativisht të rinj në grup-moshën e tyre.

Education Endowment Foundation (N.D.) Repeating a Year

Available from:

<https://educationendowmentfoundation.org.uk/education-evidence/teaching-learning-toolkit/repeating-a-year> (Accessed on 5 November 2021)

# Diskutim mbi përsëritjen e vitit

Punoni në çifte dhe diskutoni këto pyetje

Ka dëshmi të shumta se në shumicën e rasteve përsëritja e vitit është e dëmshme për perspektivën e nxënësve.

Pse disa sisteme arsimore vazhdojnë t'u kërkojnë nxënësve që ta përsërisin vitin?

Çfarë strategjish mund t'i përdorin mësimdhënësit për ta parandaluar përsëritjen e vitit nga nxënësit?

Problemi me diferencimin e të nxënit duke i grupuar nxënësit sipas lëndëve specifike (setting) ose në paralele për të gjitha lëndët (streaming)



# Çfarë është grupimi i nxënësve sipas lëndëve (setting)?

Grupimi i nxënësve sipas lëndëve (setting) zakonisht përfshin grupimin e nxënësve në grup në klasa për një vit të caktuar për lëndë specifike, si matematika dhe gjuha angleze, por jo për të gjithë kurrikulën...

# Çfarë është grupimi i nxënësve në paralele (streaming)?

Grupimi i nxënësve në paralele (streaming) përfshin grupimin e nxënësve në klasa për të gjitha ose shumicën e orëve të mësimit, në mënyrë që një nxënës të jetë në të njëjtin grup pavarësisht nga lënda që ligjërohet...



# Dëshmi kundër grupimit të nxënësve sipas lëndëve (setting) dhe grupimit në paralele (streaming)?

## Dëshmitë nga hulumtimi tregojnë se:

Mesatarisht, nxënësit që e kalojnë nëpër grupime në lëndë specifike (setting) ose grupime në paralele (streaming) bëjnë më pak përparim se nxënësit që mësojnë në klasa me arritshmëri të përzier...

Në përgjithësi, duket se grupimet sipas lëndëve ose në paralele nuk janë mënyra efektive për ta ngritur arritshmërinë e shumicës së nxënësve...

Disa studime kanë ardhur në përfundim se grupimi i nxënësve në bazë të arritshmërisë mund të ketë efekte negative afatgjata në qëndrimet dhe angazhimin e nxënësve me arritshmëri të ulët, duke e dekurajuar besimin se arritshmëria e tyre mund të përmirësohet me përpjekje...

Education Endowment Foundation (N.D.) Setting or Streaming Education Endowment Foundation

Available from

<https://educationendowmentfoundation.org.uk/education-evidence/teaching-learning-toolkit/setting-and-streaming>  
(accessed on 5 November 2021).

# Diskutim mbi grupimin ose ndarjen e nxënësve

Punoni në çifte dhe diskutoni këto pyetje

1. A i keni diferencuar ndonjëherë njësitë mësimore duke i ndarë nxënësit në klasë në 3 grupe të arritshmërisë të cilët gjithmonë bëjnë nivele të ndryshme të punës. Grupi i ulët, grupi i mesëm, grupi i lartë?

Si kanë reaguar nxënësit ndaj këtij grupimi?

2. Pse mendoni se është praktikë e dobët profesionale që të gjithë nxënësit në klasë të bëjnë saktësisht të njëjtën punë me të njëjtin ritëm?

3. Çfarë mendoni se do të thotë diferencimi sipas përmbajtjes, produktit, procesit dhe mjedisit mësimor?

Çfarë është  
diferencimi?



# Çfarë është diferencimi?

Diferencimi nënkupton përshtatjen e mësimdhënies për t'i përmbushur nevojat individuale. Pa marrë parasysh nëse mësimdhënësit e diferencojnë përmbajtjen, procesin, produktet apo mjedisin mësimor, përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm dhe grupimi fleksibël i nxënësve e bën këtë një qasje të suksesshme ndaj mësimdhënies.

Tomlinson, C. A. (2014) *The Differentiated Classroom: Responding to the Needs of All Learners*, 2nd Edition,

# Llojet e diferencimit



# Çfarë është diferencimi?

1. **Përmbajtja** – çfarë duhet të mësojë nxënësi ose si do të ketë nxënësi qasje në informata.
2. **Procesi** – aktivitete në të cilat angazhohet nxënësi për ta kuptuar ose përvetësuar përmbajtjen.
3. **Produkti** – projekte kulmore që kërkojnë nga nxënësi ta përsërisë, ta aplikojë dhe ta zgjerojë atë që ai ose ajo ka mësuar në një njësi.
4. **Mjedisi mësimor** – mënyra se si funksionon dhe ndjehet klasa.

Tomlinson, C. A. (2014) *The Differentiated Classroom: Responding to the Needs of All Learners*, 2nd Edition,

Diferencimi  
sipas  
përmbajtjes



# Aktivite të diferencimit sipas përmbajtjes

## Përmbajtjet e shtresuara

Mësimdhënësi siguron që përmbajtja të ketë nivele të ndryshme të vështirësisë.

### Shembull:

1. Përdorimi i materialeve të leximit në nivele të ndryshme.
2. Nivele të ndryshme të ushtrimeve të matematikës.

Përdorimi i pyetjeve përforcuese ose mjeteve tjera të vlerësimit formativ diagnostifikues është një element i rëndësishëm i diferencimit sipas përmbajtjes së shtresuar.

Mënyrë ideale do të ishte që nxënësit ta kuptojnë se në çfarë niveli po punojnë dhe ta zgjedhin përmbajtjen që është më e mira për ta.



# Pyetjet përforcuese

Një pyetje përforcuese është një mjet që i ndihmon mësimitdhënësit dhe nxënësit të dinë se çfarë duhet të bëjë nxënësi më pas.

Mësimitdhënësi mund t'i përdor pyetje për ta kontrolluar të kuptuarit e nxënësve përpara se të vazhdojë me njësinë mësimore.

Ne e quajmë këtë "pika përforcuese" në një orë mësimi, sepse ora e mësimit mund të shkojë në drejtime të ndryshme, varësisht nga përgjigjet e nxënësve.

# Si funksionojnë pyetjet përforcuese?

1. Pyetjet përforcuese mund të jenë pyetje me shumë zgjedhje, por për nga natyra mund të jenë edhe pyetje të hapura.
2. Qëllimi i pyetjes është të zbulohet se çfarë kupton nxënësi.
3. Çdo nxënës duhet t'i përgjigjet pyetjes brenda dy minutave.
4. Mësimdhënësi duhet të jetë në gjendje t'i mbledhë dhe interpretojë përgjigjet nga të gjithë nxënësit në më pak se 1 minutë.
5. Në këtë pikë, përgjigjet e nxënësve i japin mësimdhënësit dëshmi të vlefshme për atë që nxënësit dinë, nuk dinë dhe çfarë duhet të bëjnë më pas.

# Si funksionojnë pyetjet përforcuese?

1. Ora e mësimit vazhdon sipas planit sepse të gjithë nxënësit e kanë kuptuar konceptin.
2. Mësimdhënësi i identifikon ata që kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme. Kjo duhet të bëhet menjëherë.
3. Mësimdhënësi i trajton disa nga konceptet e gabuara që kanë rrjedhë si rezultat i pyetjeve me shumë zgjedhje.
4. Mësimdhënësi mund t'u japë grupeve të nxënësve aktivitete vijuese, përderisa t'jua mëson përsëri konceptin nxënësve tjerë.
5. Mësimdhënësi mund t'i caktojë nxënësit që e kanë kuptuar konceptin për t'i mësuar nxënësit që e kanë kuptuar. (Dëshmitë nga hulumtimi tregojnë se tutorimi i bashkëmoshatarëve mund të jetë efektiv në diferencimin e të nxënësve dhe ngritjen e rezultateve të nxënësve)

Bromley M (2017) Teaching practice

<https://www.sec-ed.co.uk/best-practice/teaching-practice-hinge-questions> (last accessed 26 May 2022)

# Si funksionojnë pyetjet përforcuese?

Pyetjet përforcuese nuk mund të bëhen në mënyrë tradicionale... d.m.th., me ngritjen e duarve...

Të gjithë nxënësit duhet të marrin pjesë dhe të gjithë duhet t'ia tregojnë përgjigjen mësimdhënësit në të njëjtën kohë.

Nxënësit mund të përdorin:

- Kartat ABCD për pyetje me shumë zgjedhje. p.sh., ngriheni lart shkronjën A nëse mendoni se përgjigjja është ....
- Karta me ngjyra të ndryshme për pyetje me shumë zgjedhje.
- Sinjale të ndryshme të dorës për të treguar përgjigjen p.sh., duart lart = po, tundja e kokës = jo, lëvizje valore me dorë = nuk jam i sigurt.
- Mini-dërrasa të bardha për t'i shkruar përgjigjet dhe për t'ia treguar mësimdhënësit.

Shkruani me shkronja të mëdha në copëza të letrës për t'ia treguar mësimdhënësit

Mësimdhënësi duhet të jetë në gjendje t'i interpretojë përgjigjet e nxënësve brenda një ose dy minutave dhe ta përshtat njësinë mësimore në bazë të të dhënave.

Video of hinge questions

# Aktivite të diferencimit sipas përmbajtjes

## Stilet e prezantimit

Mësimdhënësit duhet të paraqesin përmbajtjen duke përdorur një varg stilesh të prezantimit.

- Prezantimet e drejtuara nga mësimdhënësi.
- Llojet e ndryshme të multi-mediave.
- Modelin e klasës së përzier.



# Diferencimi sipas përmbajtjes aktivitet

## Aktivitet i bazuar në detyrë

Puna në çifte. Shikoni objektivat e njësisë mësimore më poshtë. Si do ta diferenconit sipas përmbajtjes?

Klasa 4 matematikë

Objektivi i orës së mësimi: Të mësojnë si t'i përdorin metodat e shkruara për t'i shumëzuar numrat 2 shifror me numra 2 shifror.

Klasa 9 histori

Objektivi i orës së mësimi: Ta shpjegojnë origjinën e Luftës së Parë Botërore.

Klasa 5 shkencë

Objektivi i orës së mësimi: Të identifikohen organet riprodhuese mashkullore dhe femërore.

# Përgjigje e sugjeruar

## Klasa 4 matematikë

Objektivi i orës së mësimi: Të mësojnë si t'i përdorin metodat e shkruara për t'i shumëzuar numrat 2 shifror me numra 2 shifror.

Për ta bërë diferencimin sipas përmbajtjes, mësimdhënësi do të përgatis ushtrime matematikore të niveleve të ndryshme

1. Ushtrim ku praktikohet shumëzimin e një numri 2 shifror me një numër 1 shifror.
2. Ushtrim ku praktikohet shumëzimi i një numri 2 shifror me një numër 2 shifror.
3. Ushtrim ku shumëzohet një numër 2 shifror me një numër 3 shifror.
4. Një aktivitet për zgjidhjen e problemeve që përdor shumëzimin.

Këto ushtrime mund të ruhen në Sistemin e Menaxhimit të Mësim-nxënies që nxënësit të kenë qasje përmes pajisjeve të tyre. Në një kontekst me burime të ulëta, mësimdhënësi mund t'i shkruajë nivelet e ndryshme të aktivitetit në dërrasën e zezë. Aktiviteti për zgjidhjen e problemit mund të jetë në murin e klasës përplot me sfida.



# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 9 histori

Objektivi i orës së mësimi: Ta shpjegojnë origjinën e Luftës së Parë Botërore.

Për ta bërë diferencimin sipas përmbajtjes, mësimdhënësi mund të përdorë tekste me nivele të ndryshme gjuhësore.

Nëse kjo nuk është e mundur, mësimdhënësi mund të bëjë pyetje që kërkojnë nivele të ndryshme të të kuptuarit.

Mësimdhënësi mund të përdorë burime të internetit të cilat janë shkruar për nivele të ndryshme të aftësive.

Mësimdhënësi mund të përdorë një video për të shpjeguar origjinën. Ose një video dhe një tekst.

# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 5 shkencë

Objektivi i orës së mësimit: Të identifikohen organet riprodhuese mashkullore dhe femërore.

Mësimdhënësi mund të përdorë një kombinim të fotografive dhe tekstit.

Mësimdhënësi mund të ofrojë llojllojshmëri të teksteve me nivele të ndryshme gjuhësore të cilat nxënësit i zgjedhin për t'i lexuar.

Diferencimi sipas  
procesit



# Aktivite të diferencimit sipas procesit

## Koha

Ndryshoni periudhën kohore që i nevojitet një nxënësi për ta kryer një detyrë në mënyrë që t'i ofrohet mbështetje shtesë një nxënësi që has në vështirësi, ose për ta inkurajuar një nxënës të avancuar që të ndjekë një temë më në thellësi.

# Aktivite të diferencimit sipas procesit

## Aktivitetet shtesore

Nxënësit e kryejnë të njëjtën detyrë, por aktiviteti diferencohet sipas:

1. Nivelit të mbështetjes që ata e marrin
2. Qasjes në mjete ndihmëse si fjalorët, kalkulatorët, manipuluesit
3. Qasjes në burimet digjitale që e mbështesin të nxënësit, p.sh. përpunimi i tekstit, softueri i leximit me zë, përdorimi i kamerës për incizimin e prezantimeve, etj.

# Aktivite të diferencimit sipas procesit

## Mendo-Formo qifte-Ndaj/ Kthehuni tek partneri i juaj

Mësimdhënësi i parashtron një pyetje grupit, dhe secili nxënës ka një apo dy minuta kohë për të menduar për pyetjen. Pastaj, kthehen dhe diskutojnë me ndonjë nxënës të ulur pranë tyre para se ta ndajnë atë me tërë klasën.

Ky aktivitet mund të ndihmojë në përfshirjen e të gjithë nxënësve të klasës në mësim-nxënie.

# Aktivite të diferencimit sipas procesit

## Tutorimi i shokut/shoqes së klasës

Tutorimi i shokut/shoqes përfshinë një varg qasjes në të cilat nxënësi punon në qifte ose në grupe të vogla për ta ndihmuar njëri-tjetrin në mësim-nxënie, si:

**Roli fiks**, tutorimi i aftësive të ndryshme në të cilin një nxënës merr rolin e tutorit dhe vendoset në qift me një apo më shumë nxënës tjetër, të cilët zakonisht janë më të rinj;

**Roli i tutorimit reciprok**, në të cilin nxënësit ndërrojnë rolet - një herë është tutor e radhën tjetër është nxënës.

Nxënësit marrin përgjegjësi për aspektet e mësimdhënies dhe për vlerësimin e suksesit të tyre.

# Aktivitete të diferencimit sipas procesit

## Metoda jigsaw

Jigsaw është strategji e të nxënit në bashkëpunim që i mundëson secilit nxënës të grupit "shtëpi" të specializojë në një aspekt të temës.

Nxënësit takohen me nxënësit e grupeve tjera të cilëve u është caktuar e njëjta temë.

Pasi ta zotërojnë temën, ata kthehen në grupin "shtëpi" dhe ua mësojnë materialin anëtarëve të grupit të tyre.



# Aktivite të diferencimit sipas procesit

## Të mësuarit e bazuar në problem

Nxënësit angazhohen në zgjidhjen e një situatë problematike. Problemi do të duhej të ishte pjesë e botës së tyre, ta NDJEJNË si autentik.

1. Identifikoni një skenar problematik, njoftoni nxënësit me të dhe trajtojeni një situatë të dëshiruar ose përmirësim.

Për shembull: Zhvilloni një plan për ta trajtuar problemin e mbeturinave në parqet kombëtare të Kosovës.

2. Nxënësit e kërkojnë një zgjidhje

3. Nxënësit i prezantojnë zgjidhjet e tyre

4. Reflektimet dhe vlerësimi

Nxënësit i krahasojnë rezultatet e tyre me qëllimet e të nxënësve. Rubrikat e vetë-vlerësimit / vlerësimit të shokëve të klasës / vlerësimit të mësuesve mund të jenë të dobishme.

# Aktivite të diferencimit sipas procesit

## Aktivitetet e vetë-vlerësimit

Nxënësit duhet ta vetë-vlerësojë çdo punë të vlerësuar në fund të një faze të të nxënit.  
Shembull: Test, Ese, Prezantime etj.

Rubrikat mund t'u ndihmojnë nxënësve që t'i vetë-vlerësojnë më saktë disa lëndë.

# Diferencimi sipas procesit

## Përdorimi i organizuesve grafikë

Organizuesi grafik, ndonjëherë i quajtur ueb ose hartë koncepti, mund të jetë një diagram, skicë ose grafikë në të cilën nxënësit i rregullojnë informatat. Duke përdorur organizues grafikë, nxënësit mund të:

- Mbledhin informata të rëndësishme
- Organizojnë informatat
- Përpunojnë më lehtë informatat
- Shohin marrëdhëniet ndërmjet ideve
- Kuptojnë, mbajnë mend dhe zbatojnë më lehtë informatat

# Diferencimi sipas procesit aktivitet

## Aktivitet i bazuar në detyrë

Puna në çifte. Shikoni objektivat e njësisë mësimore më poshtë. Si do ta bënit diferencimin sipas procesit?

Klasa 4 matematikë

Objektivi i orës së mësimi: Të mësojnë si t'i përdorin metodat e shkruara për t'i shumëzuar numrat 2 shifror me numra 2 shifror.

Klasa 9 histori

Objektivi i orës së mësimi: Ta shpjegojnë origjinën e Luftës së Parë Botërore.

Klasa 5 shkencë

Objektivi i orës së mësimi: Të identifikohen organet riprodhuese mashkullore dhe femërore.

# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 4 matematikë

Objektivi i orës së mësimit: Të mësojnë si t'i përdorin metodat e shkruara për t'i shumëzuar numrat 2 shifror me numra 2 shifror.

Tutorimi i shokut/shoqes së klasës Çiftet me aftësi të përziera mund të ndihmojnë në diferencim për disa.

Aktivitetet shtesore: Disa nxënës mund të marrin më shumë mbështetje.

Koha: Nxënësit mund të kenë më shumë kohë.

Zgjedhja e nxënësve: Nxënësit zgjedhin se cilin aktivitet do ta kryejnë.

# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 9 histori

Objektivi i orës së mësimi: Ta shpjegojnë origjinën e Luftës së Parë Botërore.

Aktivitetet shtesore: Disa nxënës mund të marrin më shumë mbështetje.  
Përdorimi i organizuesve grafikë: Nxënësit e zgjedhin mënyrën se si do t'i regjistrojnë informatat.

Hulumtimi bashkëpunues: Nxënësit punojnë së bashku për t'i hulumtuar informatat.

Metoda jigsaw

# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 5 shkencë

Objektivi i orës së mësimi: Të identifikohen organet riprodhuese mashkullore dhe femërore.

Përdorimi i organizuesve grafikë: Nxënësit e zgjedhin mënyrën se si do t'i regjistrojnë informatat.

Hulumtimi bashkëpunues: Nxënësit punojnë së bashku për t'i hulumtuar informatat.



Diferencimi  
sipas produktit





# Aktivite të diferencimit sipas produktit

## Zgjedhja e produktit për nxënësit

Mësimdhënësit u japin nxënësve një zgjedhje se si ta paraqesin të nxënit e tyre. Produkte të ndryshme janë më të përshtatshme për lëndë të caktuara.

Ja një listë e produkteve të mundshme:

Video Posteri Ueb-faqja Gjykim i simuluar Letër redaktorit Ekspozita Raport i lajmeve Raporti me shkrim	Shfaqje e kukullave Harta Demonstrimi Ese me fotografi Shfaqje teatrale Projekt i shkrimit krijues	Broshurë udhëtimi Këngë Poemë Prezantim në powerpoint Debat Rishfaqje Diagrami Fushatë reklamuese
--	---	--

# Aktivite të diferencimit sipas produktit

## Produktet shtesore

Produktet mund të ndahen në shtresa për ta diferencuar mënyrën se si nxënësit e demonstrojnë të nxënit e tyre.

Për shembull:

1. Disa nxënës mund ta prezantojnë të nxënit e tyre në mënyrë vizuele ose me gojë në vend që ta bëjnë një detyrë me shkrim.

2. Si sfidë, nga nxënësit mund të kërkohet që t'i aplikojnë njohuritë e tyre duke krijuar diçka.

Një nxënës i matematikës që i kupton metodat e shumëzimit me shkrim mund të krijojë probleme fjalësh për shokët e tij/saj të klasës që kërkojnë përdorimin e metodave të shumëzimit me shkrim.

# Diferencimi sipas procesit aktivitet

## Aktivitet i bazuar në detyrë

Puna në çifte. Shikoni objektivat e njësisë mësimore më poshtë. Si do ta bënit diferencimin sipas produktit?

Klasa 4 matematikë

Objektivi i orës së mësimi: Të mësojnë si t'i përdorin metodat e shkruara për t'i shumëzuar numrat 2 shifror me numra 2 shifror.

Klasa 9 histori

Objektivi i orës së mësimi: Ta shpjegojnë origjinën e Luftës së Parë Botërore.

Klasa 5 shkencë

Objektivi i orës së mësimi: Të identifikohen organet riprodhuese mashkullore dhe femërore.

# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 5 shkencë

Objektivi i orës së mësimi: Të identifikohen organet riprodhuese mashkullore dhe femërore.

Nxënësit i prezantojnë të gjeturat e tyre duke përdorur një produkt të zgjedhur prej tyre. Për shembull: Diagrami me shënime, posterit.



# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 4 matematikë

Objektivi i orës së mësimi: Të mësojnë si t'i përdorin metodat e shkruara për t'i shumëzuar numrat 2 shifror me numra 2 shifror.

Si sfidë, disa nxënës mund ta zhvillojnë një kuiz ose t'i hartojnë problemet e tyre që kërkojnë shumëzim për t'i zgjidhur.

# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 9 histori

Objektivi i orës së mësimi: Ta shpjegojnë origjinën e Luftës së Parë Botërore.

Zgjedhja e produktit për nxënësit:

1. Prezantim në powerpoint
2. Ese
3. Raport i lajmeve

Diferencimi  
sipas mjedisit  
mësimit



# Diferencimi sipas mjedisit mësimor

## Rregullimi i klasës

1. Sigurohuni që të ketë vende në klasë për të punuar në qetësi dhe pa u shpërqendruar.
2. Sigurohuni që ka vende në klasë ku nxënësit mund të punojnë në bashkëpunim.



# Diferencimi sipas mjedisit mësimor

Rutina në klasë

Zhvillimi i rutinës që u mundëson nxënësve të kërkojnë ndihmë kur mësimdhënësit janë të zënë me nxënësit tjerë dhe nuk mund t'u ndihmojnë atyre menjëherë.

- Fillimisht pyetni partnerin tuaj.
- Kaloni tek pyetja tjetër ndërkohë që e pritni ndihmën.

# Diferencimi sipas mjedisit mësimor

## Aktivitetet shtesë

Krijoni aktivitete shtesë në fillim të semestrit në të cilat nxënësit mund të kenë qasje kur e përfundojnë punën e tyre.

## Për shembull:

1. Një ekspozitë në mur përplot sfida që nxënësit duhet t'i kryejnë.
2. Fletë pune shtesë për nxënësit që të praktikojnë.
3. Një bibliotekë të vogël në klasë. (E krijuar nga donacionet e prindërve, ish-nxënësve)
4. Një hapësirë në klasë me kompjuterë që mund të përdoret për të diferencuar mësimin dhe për t'i aplikuar shkathhtësitë digjitale. (Ndoshta nga donacionet)

# Diferencimi sipas mjedisit mësimor

## Aktivitet i bazuar në detyrë

Puna në çifte. Shikoni objektivat e njësisë mësimore më poshtë. Si do ta diferenconit mjedisin mësimor për t'i mbështetur rezultatet e nxënësve?

Klasa 4 matematikë

Objektivi i orës së mësimi: Të mësojnë si t'i përdorin metodat e shkruara për t'i shumëzuar numrat 2 shifror me numra 2 shifror.

Klasa 9 histori

Objektivi i orës së mësimi: Ta shpjegojnë origjinën e Luftës së Parë Botërore.

Klasa 5 shkencë

Objektivi i orës së mësimi: Të identifikohen organet riprodhuese mashkullore dhe femërore.

# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 4 matematikë

Objektivi i orës së mësimi: Të mësojnë si t'i përdorin metodat e shkruara për t'i shumëzuar numrat 2 shifror me numra 2 shifror.

Përdorni një mur ekspozues të sfidave për nxënësit. Siguro hapësira të punës për disa nxënës ku ata nuk do të shpërqendrohen.

# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 5 shkencë

Objektivi i orës së mësimi: Të identifikohen organet riprodhuese mashkullore dhe femërore.

Rregulloni klasën në mënyrë që nxënësit të mund të punojnë vetëm, në çifte ose grupe. Sigurohuni që ora e mësimi të jetë me nxënësin në qendër.



# Përgjigje e sugjeruar

Klasa 9 histori

Objektivi i orës së mësimi: Ta shpjegojnë origjinën e Luftës së Parë Botërore.

Ofroni nxënësve zgjedhje për hapësirën e punës që ata e preferojnë.



*Zgjedhja e  
metodës së  
diferencimit*



# Zgjedhja e metodës së diferencimit

Para se ta planifikojë orën e mësimit, mësimpldhënësi duhet të vendosë se cili lloj i diferencimit është më i përshtatshëm për nxënësit.		
Cili është konteksti?	Lloji i diferencimit	Veprimi
Nxënësi nuk ka njohuri të mjaftueshme paraprake për t'iu qasur detyrës.	Diferenconi sipas përmbajtjes së shtresuar.	Sigurohuni që nxënësit t'i jepet punë që siguron një bazë për detyrën ndërsa nxënësit që kanë njohuri punojnë në detyrë.
Nxënësi arrin rezultate të larta.	Diferenconi sipas përmbajtjes dhe sipas produktit.	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Caktoni nxënësit përmbajtje më sfiduese.</li><li>2. Kërkoni nga nxënësi ta prodhojë një produkt më të sofistikuar. P.sh. Jo vetëm të demonstrojnë njohuri, por edhe t'i zbatojnë njohuritë për të krijuar diçka.</li></ol>
Nxënësi e ka të vështirë të punojë me të tjerët.	Diferencimi sipas procesit	Mundësojani nxënësit të punojë vetëm.



Rubrika



# Çfarë është rubrika?

Rubrika është një mjet vlerësimi që tregon qartë kriteret e të arriturave përgjatë të gjithë komponentëve të çfarëdo pune të nxënësve, me shkrim, me gojë dhe vizuale.

Rubrika mund të përdoret për notimin e detyrave, pjesëmarrjen në klasë ose notat e përgjithshme.

Ekzistojnë dy lloje rubrikash: holistike dhe analitike.

Rubrika holistike i grupon disa kriteret të ndryshme të vlerësimit dhe i klasifikon ato së bashku.

Rubrika analitike i ndanë kriteret e ndryshme të vlerësimit dhe i adreson ato në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Rubrics Useful Assessment tools University of Waterloo

[http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata\\_\\_07%20National%20and%20government%20accounts\\_\\_National%20accounts\\_\\_Annual%20national%20accounts/gdp09.px/table/tableViewLayout1/?rxid=ad787284-363a-44a5-bb3d-0f067afa36b7](http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata__07%20National%20and%20government%20accounts__National%20accounts__Annual%20national%20accounts/gdp09.px/table/tableViewLayout1/?rxid=ad787284-363a-44a5-bb3d-0f067afa36b7) [accessed 25 May 2022]

# Çfarë është rubrika?

Rubrika është një mjet vlerësimi, i cili përshkruan nivelet e arritjeve në një fushë të caktuar të performancës, të kuptuarit ose sjelljes.

Rubrikat përbëhen nga katër pjesë themelore. Në formën e saj më të thjeshtë, rubrika përfshin:

# Çfarë është rubrika?

1. **Përshkrimin e detyrës.** Rezultati që vlerësohet ose udhëzimet që i kanë marrë nxënësit për një detyrë.
2. **Karakteristikat që do të vlerësohen (rreshtat).** Aftësitë, njohuritë dhe/ose sjelljet që duhet të demonstrohen.
3. **Nivelet e zotërimit/shkalla (kolonat).** Emërtimet që përdoren për t'i përshkruar nivelet e zotërimit duhet të jenë me takt dhe të qarta. Emërtimet e përdorura zakonisht përfshijnë:
  1. Nuk i përmbushë, u ofrohet, i përmbushë, i tejkalon.
  2. Shembullor, i aftë, marginal, i papranueshëm
  3. I avancuar, niveli i mesëm i lartë, i mesëm, fillestar
  4. 1, 2, 3, 4

# Rubrika e të nxënit bashkëpunues

## Klasa 4

Kategoria	4	3	2	1
Kontributi në grup	Ndihmon të gjithë anëtarët e grupit në mënyrë konsistente dhe aktive në përfundimin e projektit	Punon në projektin e grupit pasi i kërkohet herë-pas-herë. 3+ herë	Punon në projektin e grupit pasi i kërkohet shpeshherë. 5+ herë	Punon në projektin e grupit vetëm kur kjo gjë i kërkohet.
Puna dhe ndarja me të tjerët	Bashkëpunon me të gjithë anëtarët e grupit dhe me dëshirë pranon idetë e tjerëve.	Bashkëpunon me shumicën e anëtarëve të grupit dhe pranon shumicën e ideve nga tjerët.	Nuk bashkëpunon me shumicën e anëtarëve të grupit dhe pranon disa ide nga tjerët.	Nuk bashkëpunon mirë me të gjithë anëtarët e grupit dhe nuk pranon ide nga tjerët.
Përqendrimi në detyrë	Qëndron në detyrë gjatë tërë projektit.	Qëndron në detyrë në pjesën më të madhe të projektit.	Qëndron në detyrë vetëm gjatë një pjese të projektit.	Nuk qëndron në detyrë gjatë projektit.
Prezantimi	Pjesëmarrje aktive në prezantimin e rezultateve të aktivitetit.	Pjesëmarrje në prezantimin e rezultateve të aktivitetit.	Pjesëmarrje e vogël në prezantimin e rezultateve të aktivitetit.	Nuk merr pjesë në prezantimin e rezultateve të aktivitetit.

# Pse duhet mësimdhënësit t'i përdorin rubrikat?

Rubrikat u ndihmojnë mësimdhënësve të:

1. Vlerësoni detyrat në mënyrë të vazhdueshme nga një nxënës tek tjetri.
2. Ofrojë informata kthyesë efektive dhe të cilësisë së lartë që u ndihmon nxënësve të përparojnë.

Using Rubrics Cornell University <https://teaching.cornell.edu/teaching-resources/assessment-evaluation/using-rubrics> (Last accessed on 25 May 2022)

# Pse duhet mësimdhënësit t'i përdorin rubrikat?

Rubrikat u ndihmojnë mësimdhënësve të:

3. Sqaroni pritshmëritë e mësimdhënësit për detyrën dhe komponentët e detyrës që vlerësohet.
4. Vlerësoni dhe përmirësoni metodat e tyre të mësimdhënies duke i vlerësuar rezultatet e rubrikës

Using Rubrics Cornell University <https://teaching.cornell.edu/teaching-resources/assessment-evaluation/using-rubrics> (Last accessed on 25 May 2022)

# Pse duhet mësimdhënësit t'i përdorin rubrikat?

5. Rubrikat i ndihmojnë mësimdhënësit që ta vlerësojnë në mënyrë formative përvetësimin e shkathtësive kur nxënësit punojnë në projekte ose detyra për zgjidhjen e problemeve.

Për shembull: Nëse një grup nuk funksionon mirë së bashku, referimi tek një rubrikë mund t'i fokusojë nxënësit në aftësitë bashkëpunuese.

Mësuesi mund të ndërhyjë, të shtoj dhe t'u mësojë nxënësve këto aftësi.



# Pse duhet mësimdhënësit t'i përdorin rubrikat?

Rubrikat u ndihmojnë mësimdhënësve të:

1. Kuptojnë pritshmëritë dhe komponentët e një detyre.
2. Bëhen nxënës të vetë-rregulluar.  
Ata bëhen më të vetëdijshëm se si mësojnë dhe si mund të përmirësohen.

Using Rubrics Cornell University <https://teaching.cornell.edu/teaching-resources/assessment-evaluation/using-rubrics> (Last accessed on 25 May 2022)

# Pse duhet mësimdhënësit t'i përdorin rubrikat?

Rubrikat u ndihmojnë mësimdhënësve të:

1. Përmirësojnë punën e tyre nëpërmjet informatave kthyesë të fokusuara dhe specifike.
2. Ndhmojnë nxënësit që të fokusohen në aftësi, si dhe në përmbajtje.

Using Rubrics Cornell University <https://teaching.cornell.edu/teaching-resources/assessment-evaluation/using-rubrics> (Last accessed on 25 May 2022)

# Zhvillimi i një rubrike

Hapi 1: Identifikoni çfarë dëshironi të vlerësoni

Hapi 2: Identifikoni karakteristikat që do të vlerësohen (rreshtat).

- Specifikoni aftësitë, njohuritë dhe/ose sjelljet që do t'i kërkon.
- Kufizoni karakteristikat në ato që janë më të rëndësishme për vlerësimin.

# Zhvillimi i një rubrike

Hapi 3: Identifikoni dhe përshkruani nivelet e zotërimit/shkallës (kolonat).

- Përshkruani punën më të mirë që mund të prisni duke përdorur këto karakteristika. Kjo e përshkruan kategorinë më të lartë.
- Përshkruani një produkt të papranueshëm. Kjo e përshkruan kategorinë më të ulët.
- Zhvilloni përshkrimet e produkteve të nivelit të mesëm për kategoritë e mesme.

Hapi 4: Testoni rubrikën dhe aplikoni rubrikën në një detyrë.

# Rubrika e një projekti shkencor

Fusha e vlerësimit	Niveli i avancuar 4	Niveli i avancuar 3	Niveli i avancuar 2	Niveli i avancuar 1
Originaliteti i pyetjes	Hulumtimi origjinal	Perspektiva unike mbi një projekt tradicional	E zbukuron një ide ekzistuese	Pa originalitet (projekt i konservuar)
Pyetje testuese	Ekziston një qëllim/përfitim i caktuar për shoqërinë; me kohë dhe relevante; ofron zgjidhje për problemet reale	Projekti ka qëllim/përfitim për shoqërinë	Qëllimi/përfitimi është i paqartë	Nuk ndonje lidhje për zgjidhjen e problemeve reale në botë
Hipoteza	E zhvilluar tërësisht me “unë mendoj... sepse...”	Mjaftueshëm e zhvilluar	Pjesërisht e zhvilluar	Të meta të mëdha
Materialet	Lista e plotë që detajon se si të tjerët mund t'i replikojnë rezultatet me matje të sakta në njësi metrike	Lista komplete	Listë e pjesshme ose nuk përdor njësi metrike	Listë e pa kompletuar; nuk është në gjendje ta replikojë projektin siç është shkruar
Procedurat/organizimi	Lehtë për ta ndjekur sekuencën e metodës shkencore. Gjuha është e qartë dhe e saktë.	Lehtë për ta ndjekur sekuencën e metodës shkencore. Disa gabime gjuhësore.	Deri diku vështirë për t'u ndjekur për shkak të gabimeve në sekuencën e metodës shkencore.	Vështirë për t'u ndjekur; nuk ka sekuence në metodën shkencore.
Provot e hulumtimit/madhësia e mostrës	Eksperimenti është kryer më shumë se 2 herë ose nëse janë përdorur të dhënat e anketës, të dhënat janë mbledhur nga 50+ persona.	Eksperimenti është kryer 2 herë ose nëse janë përdorur të dhënat e anketës, të dhënat janë mbledhur nga 30-49 persona	Eksperimenti është kryer 1 herë ose nëse janë përdorur të dhënat e anketës, të dhënat janë mbledhur nga 10-29 persona	Eksperimenti nuk është kryer në mënyrë të plotë ose nëse janë përdorur të dhënat e anketës, të dhënat janë mbledhur nga më pak se 10 persona
Analiza	Të dhënat paraqiten qartë dhe lidhen drejtpërdrejt me hipotezën/pyetjen	Të dhënat paraqiten në mënyrë të arsyeshme dhe tregojnë një lidhje të mirë me hipotezën/pyetjen	Të dhënat paraqiten në mënyrë minimale dhe tregojnë një lidhje me hipotezën/pyetjen	Të dhënat paraqiten dhe nuk tregojnë asnjë lidhje me hipotezën/pyetjen
Vlerësimi/konkluzionet	Nga të dhënat e mbledhura është nxjerrë një përfundim logjik, i cili i përgjigjet hipotezës/pyetjes dhe/ose ngre një hipotezë/pyetje të re. Ka aplikim në jetën reale.	Nga të dhënat e mbledhura është nxjerrë një përfundim logjik.	Nga të dhënat e mbledhura është nxjerrë një përfundim i arsyeshëm.	Përfundimi i nxjerrë nuk tregon se ndërlidhet me të dhënat e mbledhura.
Tabela e ekspozimit; prezantim fizik dhe/ose vizual	I plotëson të gjitha kriteret e nivelit profesional; përveç kësaj, tregon përdorimin e veçantë të teknologjisë së përshtatshme ose talente të veçanta artistike.	Projekti është vizualisht tërheqës (i emërtuar, i organizuar, afërt, me ngjyra, konciz, i lehtë për t'u parë nga një distancë, dhe përmban informata të rëndësishme dhe detaje mbështetëse).	Projekti është vizualisht tërheqës, por i mungon konsistenca në të paktën një fushë të përmendura të nivelit profesional.	Projekti është i kompletuar por mungon konsistenca në disa fusha të përmendura të nivelit profesional.

# Aktiviteti për vlerësimin e rubrikës Mësim-nxënie e bazuar në detyrë

Puna në çifte.

Analizoni planin mësimor në sllajdin/fletushkën e mëposhtme.

Hartoni një rubrikë për njësinë mësimore që nxënësit, bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit mund ta përdorin për ta vlerësuar cilësinë e punës.

Vlerësoni me notë punën duke përdorur 1-5, por bëni dallimet e qarta dhe transparente ndërmjet secilës notë.

Mendoni për aftësitë dhe përmbajtjen.

1	2	3	4	5

Plani mësimor: Gjeografi, klasat 5 – 8 (plani mësimor duhet të përshtatet sipas moshës së nxënësve)

<p>Objektivat e të nxënët</p>	<p><b>Aktivitetet e mundshme të mësimdhënies dhe mësim-nxënies</b>                  Aktivitetet duhet të përshtaten duke u bazuar në vlerësimin formativ të njëjësive mësimore. Mësimdhënësit duhet të reagojnë ndaj të dhënave të vlerësimit formativ dhe ta përshtatin orën e tyre mësimore për t'i përmbushur nevojat e nxënësve</p>	<p>Kriteret e suksesit (Si mund ta dinë nxënësit se çfarë kanë arritur?... rubrika, etj.)</p>	<p>Vlerësimi/Mundësitë e dhënies së informatave kthyesë (Vetë-vlerësi mi i nxënësve/vlerësimi i shekeve të klasës/informatat kthyesë me gojë të mësimdhënësit sipas nevojës)</p>
<p>Nxënësit do të kuptojnë pse ndodhin veçoritë e ndryshme të lumenjve në nivele të ndryshme të lumenjve.</p>	<p><b>Fillimi i orës mësimore (aktivitet i ngrohjes – jo vetëm detyrat e shtëpisë)</b>                  Shkruani sa më shumë emra të lumenjve që mundeni brenda 2 minutave.                  Cili lumë në listën e juaj kalon nëpër shumicën e shteteve.  <b>Aktiviteti (Aktivitete të ndryshme që udhëhiqen nga nxënësit dhe mësimdhënësi)</b>                  Në grupe nga 4 veta hulumtoni veçoritë e sistemit të lumit. Pastaj, dizajnoni dhe krijoni një model 3 D. Shkruani dhe bëni një prezantim lidhur me lumenjtë duke e përdorur modelin 3 D për ta ilustruar prezantimin.  <b>Diferencimi sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe mjedisit mësimor</b>  <b>Diferencimi sipas produktit.</b>                  Sfida shtesë për nxënësit Bëni një prezantim 3 D të lumit Danub ose lumit Amazona në bazë të njohurive tuaja paraprake (ju nuk mund ta përdorni Atlasin!).  <b>Kontrollimi i mësim-nxënies (pyetjet e vlerësimit formativ (pyetjet përforcuese)? .. strategjitë e vlerësimit formativ)</b>                  A janë kanalet në formë gjarpërore apo krijojnë liqene. Pse nuk paraqitet delta në rrjedhën e sipërme të lumit?</p>	<p>Nxënësit do të jenë në gjendje t'i identifikojnë emrat e veçorive të rrjedhës së sipërme, rrjedhës së mesme dhe rrjedhës së ulët të lumit.</p> <p>Nxënësit do të jenë në gjendje të shpjegojnë pse veçoritë e ndryshme ndodhin në nivele të ndryshme të lumit.</p>	<p>Nxënësit i vlerësojnë përgjigjet e njëri tjetrit të pyetjeve në tekstin shkollor.</p> <p>Nxënësit e vetë-vlerësojnë modelin e tyre 3 D dhe prezantimin duke e përdorur rubrikën.</p>

Shembuj të  
praktikës së  
varfër  
pedagogjike





# Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike në Kosovë

Mësimdhënësit nuk i planifikojnë njësitë mësimore.



# Zgjidhja

Planet mësimore nuk kanë nevojë të jenë të detajuara, por ato duhet përfshijnë:

- Objektivin e qartë të të nxënit dhe kriteret e suksesit.
- Shumëllojshmërinë e strategjive pedagogjike (me kalimin e kohës).
- Strategjitë e vlerësimit formativ të ciklit të shkurtër. (p.sh. pyetjet përforcuese, vlerësimet diagnostifikuese duke përdorur mini tabela të bardha)
- Diferencimin sipas përmbajtjes, procesit, produktit dhe/ose mjedisit mësimor.
- Sfidën. Mësimdhënësit duhet të përpiqen të planifikojnë një sfidë për nxënësit në çdo orë mësimi.

# Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike në Kosovë

Mësimdhënësit nuk reagojnë ndaj asaj që ndodhë në klasë.

Mësimdhënësit ligjërojnë prezantime pa i përdorur strategjitë e vlerësimit formativ të ciklit të shkurtër. Kjo rezulton në atë që mësimdhënësit e prezantojnë përmbajtjen që nuk paraqitet në nivelin e duhur për nxënësit.

# Zgjidhja

Planifikoni pyetjet përforcuese dhe strategjitë tjera reaguese të mësimdhënies në orën e mësimit.

*Duke e bërë këtë, njësia mësimore mund të përshtatet në kohë reale për t'i përmbushur më mirë nevojat individuale të nxënësve.*

# Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike në Kosovë

E gjithë klasa e zhvillon një aktivitet ku *niveli i vështirësisë është i njëjtë për çdo nxënës.*



# Zgjidhja

Tekstet e dobëta mësimore e bëjnë këtë më të vështirë për mësimdhënësit. Megjithatë, mësimdhënësit mund të përfshijnë sfida në mënyra të ndryshme.

Tutorimi i shokëve të klasës i mbështet nxënësit, por edhe paraqet sfida për tutorin në klasë sepse kërkon rikujtim dhe përpunim aktiv të njohurive.

Mësimdhënësit mund të krijojnë një mur sfidues në klasë. Sfidat që mund t'i bëjnë nxënësit nëse përmbajtja e njësive mësimore është shumë e lehtë.

Nxënësve mund t'u jepet një zgjedhje e aktiviteteve të bazuara.

# Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike në Kosovë

Mësimdhënësit i regjistrojnë të dhënat e vlerësimit formativ, por ato nuk u përgjigjen të dhënave, dhe si rezultat e përshtatin njësinë mësimore.



# Zgjidhja

Përgjigjuni klasës.

1. Nëse klasa nuk angazhohet, përdorni strategjinë aktive të të nxënit për t'i angazhuar ata. (Mendo - ndajë në çifte është një strategji që shfrytëzohet shumë pak nga shumë mësimdhënës.)
2. Nëse njësia mësimore është shumë e lehtë, përshtateni atë.
3. Nëse njësia mësimore është shumë e vështirë, përshtateni atë.
4. Sigurohuni që të ketë aktivitete në klasë për t'i sfiduar nxënësit ose mbështetur ata sipas nevojës.



# Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike në Kosovë

Mësimdhënësit që u bëjnë pyetje vetëm tre-katër nxënësve në klasë që e ngritin dorën.



# Zgjidhja

1. Përdorni strategjitë e të nxënit aktiv rregullisht Mendon ndajë në çifte/ Ktheju partnerit juaj. Jepuni të gjithë nxënësve mundësi të përgjigjen në pyetje para se ta identifikoni një nxënës publikisht.
2. Përdorni pyetje përforcuese ose strategji të të nxënit reagues për tërë klasën për t'i vlerësuar njohuritë e tërë klasës dhe për t'u dhënë të gjithë nxënësve mundësi që të përgjigjen në pyetje.

# Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike në Kosovë

Mësimdhënësit që u japin nota nxënësve pa informata kthyesë me shkrim apo me gojë lidhur me atë se çfarë kanë bërë mirë dhe çfarë duhet përmirësuar.

Vlerësimi i nxënësve me notë duke bazuar në mendimin e mësimdhënësit në vend të kriterëve të qarta të suksesit.

Duke i etiketuar nxënësit në këtë mënyrë mund të jenë poshtëruese dhe nuk i ndihmon ata që t'i identifikojnë fushat që duhet t'i përmirësojnë.

# Zgjidhja

Kurrë mos u jepni nxënësve notë pa informata kthye.

1. Ndani kohë gjatë orës së mësimit për të dhënë informata kthye me gojë dhe me shkrim. Informatat kthye me gojë dhe me shkrim duhet t'i identifikojnë fushat se ku duhet të përmirësohen nxënësit dhe cilat janë hapat e mëtejshëm në rrugëtimin e tyre të nxënies.
2. Përdorni rubrikat për ta bërë vlerësimin më transparent ndërmjet nxënësit dhe mësimeve.
3. Kërkoni nga nxënësit që fillimisht ta vlerësojnë vetë tërë punën e rëndësishme. Pastaj kërkoni nga nxënësit që ta vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. Më pastaj, vlerësoni punën e tyre si mësime.

# Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike në Kosovë

Mësimdhënësi duke e shfaqur në klasë një video ose film pa i përdorur strategjitë e të nxëniet aktiv ose vlerësimin formativ të ciklit të shkurtër.

Shikimi i një videoje është aktivitet pasiv.

# Zgjidhja

1. Kërkoni nga nxënësit të mbajnë shënime të cilat pastaj i krahasojnë me ato të partnerit.
2. Marrja e shënimeve jigsaw: Kërkoni nga nxënësit që të mbajnë shënime për pjesë të ndryshme të videos. Pastaj, nxënësit mblidhen në grup për të marrë shënime për videon në tërësi.
3. Ndaleni videon në mënyrë që nxënësit fillimisht ta dëgjojnë atë pa i parë fotografitë. Pastaj e lëshon videon që ta shohin atë me fotografi.
4. Ndale videon për të bërë pyetje, por mos u bëjë pyetje vetëm 1 ose 2 nxënësve.
  1. Përdorni strategjinë mendo-ndaj në çifte për ta përfshirë tërë klasën.
  2. Bëju pyetje përforcuese tërë klasës për të kontrolluar se a kanë kuptuar.

# Shembuj të praktikës së varfër pedagogjike në Kosovë

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve që ta hulumtojnë një temë duke përdorur internetin pa u dhënë ndonjë udhëzim apo përgatitje.

- Kështu humb koha e orës së mësimit.
- Nxënësit hyjnë në ueb-faqe që nuk janë të qasshme për shkak të barrierave gjuhësore.
- Ky është një aktivitet pasiv.

# Zgjidhja

1. Mësimdhënësi duhet t'i hulumtojë ueb-faqet e përshtatshme dhe t'i ndajë ato me nxënësit.
2. Aktiviteti hulumtues duhet ta ketë një objektiv të qartë dhe kritere të qarta të suksesit.
3. Mësimdhënësi duhet ta ndërpresë aktivitetin hulumtues në intervale kohore për t'i inkurajuar nxënësit të reflektojnë lidhur me të nxënit dhe për ta vlerësuar në mënyrë formative përparimin e nxënësve.
4. Mësimdhënësi mund ta ndajë orën e mësimit sipas strategjive të të nxënit aktiv, si p.sh. mendo-ndajë në çifte.
5. Mësimdhënësi mund të kërkojë nga nxënësit që të reflektojnë mbi punën e tyre në intervale të ndryshme.



Tejkalimi i  
barrierave në një  
shkollë me burime  
të pamjaftueshme



# Veçoritë e një shkolle me burime të pamjaftueshme

Veçoritë e një shkolle me burime të pamjaftueshme

1. Nuk ka qasje në tekste cilësore
2. Kushte të dobëta pune
  1. P.sh. nuk ka laboratorë të shkencave.
3. Ka mungesë të burimeve praktike.
  1. P.sh. nuk ka modele 3D, manipulues për orët e matematikës
4. Mungesë të burimeve digjitale. Mungesë të kompjuterëve, projektorëve, lidhje të dobët të internetit.
5. Mungesë të stafit

# Barrierat e një shkolle me burime të pamjaftueshme

Tekste shkollore të cilësisë së dobët

Mësimdhënësit e mirë nuk mbështeten në një tekst shkollor për ta realizuar kurrikulën.

Megjithatë, nëse teksti kryesor është i cilësisë së dobët, kjo është jashtëzakonisht sfiduese për çdo mësimdhënës.

# Zgjidhjet e mundshme

Tekste shkollore të cilësisë së dobët

Përdorimi i burimeve të internetit dhe programeve të përkthimit mund t'u japë mësimdhënësve qasje në burime të shumta cilësore.

Burimet e cilësisë së lartë mund të ngarkohen në një sistem të menaxhimit të të nxënit (p.sh. Google classroom).

Nëse pajisjet digjitale nuk lejohen në shkollë, burimet e ngarkuara mund të qasen në shtëpi për të ofruar përmbajtje të cilësisë së lartë.

Mësimdhënësit pastaj mund ta shfrytëzojnë kohën e orës së mësimi për t'i adresuar konceptet e gabuara dhe për të lehtësuar më shumë aktivitete të fokusuara në nxënës.

# Barrierat e një shkolle me burime të pamjaftueshme

Mungesa e burimeve digjitale në shkollë

Nxënësit nuk kanë qasje në kompjuterë në shkollë.



# Zgjidhjet e mundshme

## Mungesa e burimeve digjitale në shkollë

1. Nëse është e mundur, kërkoni nga nxënësit t'i sjellin pajisjet e tyre.

Nëse nxënësit nuk kanë laptopë, telefonat celularë mund të përdoren për t'u qasur në materialet në sistemin e menaxhimit të mësim-nxënies.

- Kjo kërkon rregulla të qarta të shkollës dhe menaxhim efektiv të klasës për të shmangur ndërprerjen e mësimimit.
- Kjo, po ashtu, kërkon planifikim të kujdesshëm në mënyrë që fëmijët më pak të privilegjuar të mos përjashtohen.

# Zgjidhjet e mundshme

Mungesa e burimeve digjitale në shkollë

2. Përdorni qasjen e klasës së përzier.

Përdorni sistemin e menaxhimit të mësim-nxënies (p.sh. google classroom) për ta ngarkuar përmbajtjen e njësisë mësimore. Nxënësit i qasen përmbajtjes në shtëpi për detyrat e shtëpisë. Pastaj, ora mësimore përdoret për ta aplikuar përmbajtjen ose për t'i adresuar konceptet e gabuara.

Nëse pajisjet digjitale nuk lejohen në shkollë, burimet e ngarkuara në sistemin e menaxhimit të mësim-nxënies mund të qasen në shtëpi për të ofruar burime të diferencuara.

Barrierat e një  
shkolle me  
burime të  
pamjaftueshme

Qasje e kufizuar në printerë dhe aparate fotokopjimi për t'i  
kopjuar burimet e reja.





## Zgjidhjet e mundshme

Qasje e kufizuar në printerë dhe aparate fotokopjimi për t'i kopjuar burimet e reja.

1. Sillni pajisjen tuaj në shkollë / dhe ose klasën e përzier

Mësimdhënësit ngarkojnë burime të diferencuara në sistemin e menaxhimit të mësim-nxënies. Nxënësit mund t'i qasen burimeve nëpërmjet telefonit celular ose kompjuterit që e kanë sjellë në shkollë.

Nëse pajisjet digjitale nuk lejohen në shkollë, burimet e diferencuara mund të qasen në shtëpi.

## Zgjidhjet e mundshme

Qasje e kufizuar në printerë dhe aparate fotokopjimi për t'i kopjuar burimet e reja.

Tabelat e klasës dhe muret mund të përdoren për t'i shfaqur aktivitetet e diferencuara.

Për shembull:

- Teksti shkollor mund të ketë aktivitetin kryesor.
- Një tabelë mund të përmbajë aktivitete më të lehta për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje.
- Njëri mur i klasës mund të përmbajë sfida për një javë që nxënësit mund t'i bëjnë kur t'i përfundojnë aktivitetet kryesore.

# Barrierat e një shkolle me burime të pamjaftueshme

Mungesa e burimeve praktike.

- Klasat nuk kanë tabela të bardha të vogla për vlerësimin formativ.
- Nxënësit nuk kanë qasje në manipulues për t'u ndihmuar në nxënien e lëndës së matematikës.
- Klasat e lëndëve shkencore nuk kanë modele 3D

## Zgjidhjet e mundshme

Përdorni kohën e mësimit për të krijuar burime.

- Nxënësve mund t'u jepet një aktivitet i bazuar në projekt në fillim të vitit për të krijuar burime për vetveten ose për grupmoshat e tjera.
- Mini-tabelat e bardha janë një burim i lirë për t'u blerë, por ato gjithashtu mund të bëhen duke përdorur burime të ricikluara.
- Mësimdhënësit e artit dhe dizajnit mund të ndihmojnë në krijimin e burimeve për fushat tjera të kurrikulës.

# Aktiviteti i citateve të nxënësve

## Diskutim në çifte

Puna në çifte.

Lexoni/dëgjoni citimet e nxënësve në Kosovë në vitin 2022.

Cilave lloje të praktikës së dobët pedagogjike i referohen këto citate?

# Citate nga nxënësit kosovarë në vitin 2022

Alea 8

Matematika është vertet e lehte!



Klea 8

Matematika më duket e lentë. Në matematikë, mësimdhënësi më jep shumë detjra... Detjra jo të vështira



Valeria 9

Anglishtja dhe matematika janë të lehta



Velya 10

Do të doja të bëja gjëra më të avancuara



# Citate nga nxënësit kosovarë në vitin 2022

Isa 10

Nxënësit duhet të dëgjojnë më shumë



Sara 9

Nxënësit duhet të dëgjojnë, të mesojnë dhe të jenë të qetë!



Nerona 8

Do të doja që secili nxënës të mesojë. Ata duhet të dëgjojnë dhe të mesojnë. Do vetëm të jenë të pranishëm.



Erjon 17

Në kurrë nuk bëjmë eksperimente praktike në kimi apo biologji



Genci 11

Do të doja të kisha arsimim më të mirë

## Përgjigje e sugjeruar

Nxënësit shpesh thonë se puna është e lehtë. Ky nuk është koment pozitiv. Kjo do të thotë se ata nuk sfidohen në shkollë.

Kjo është ndoshta për shkak se mësime dhënësit e tyre nuk e përdorin strategjitë e vlerësimit formativ të ciklit të shkurtër në klasë ose diferencimin e të nxënës të tyre sipas përmbajtjes, procesit, produktit ose mjedisit të mësim-nxënies. Mësime dhënësit e tyre nuk planifikojnë, sfidojnë në orët e tyre të mësimi.

Shumë nxënës duket se mendojnë se mund të mësojnë vetëm duke e dëgjuar mësime dhënësin. Kjo sugjeron që ata nuk i përjetojnë shpesh aktivitetet e të nxënës aktiv ose bashkëpunuese.

Citimet, po ashtu, sugjerojnë se ata nuk i kanë mësuar strategjitë e të nxënës të vetë-rregulluar.



Praktika më e  
mirë e  
mësimdhënies  
reaguese



# Praktika më e mirë mbi të nxënit e diferencuar

Nxënësit e vetë-vlerësojnë tërë punën e tyre duke u bazuar në kritere të qarta.

Çdo test notohet fillimisht nga nxënësi..

Puna e rëndësishme është:

- E vetë-vlerësuar
- E vlerësuar nga shokët e klasës
- E vlerësuar nga mësimitdhënësi

# Praktika më e mirë mbi të nxënit e diferencuar

Nxënësve u jepen zgjedhje domethënëse për atë që mësojnë dhe si mësojnë.

Individualisht, në çift, në grup.

Disa nxënës nuk punojnë mirë në bashkëpunim dhe mund të preferojnë të punojnë vetëm.

Diferencimi sipas procesit

# Praktika më e mirë mbi të nxënit e diferencuar

Nxënësit bëjnë rregullisht hulumtime bashkëpunuese dhe ushtrime për zgjidhjen e problemeve duke u bazuar në kritere të qarta të suksesit.

Mësimdhënësi u referohet shpesh këtyre kritereve të suksesit për të siguruar fokusimin në objektivin e të nxënit.

Diferencimi sipas procesit

Të gjeturat e hulumtimit mund të paraqiten ndryshe

Diferencimi sipas produktit

# Praktika më e mirë mbi të nxënit e diferencuar

Nxënësve u jepet mundësi që ta regjistrojnë dhe ta paraqesin mësim-nxënien e tyre në mënyra të ndryshme. Nxënësit e ndihmojnë njëri-tjetrin ta hulumtojnë të njëjtën temë, por t'i paraqesin të gjeturat e tyre në mënyra të ndryshme.

## Diferencimi sipas procesit

Është thelbësore që të zhvillohen aftësitë e shkrim-leximit në të gjitha lëndët, por mësim-nxënia mund të paraqitet në mënyra të ndryshme.

# Diskutim mbi praktikën më të mirë

## Diskutim në çifte

Punoni me partnerin. Lexoni dy letra të nxënësve në Kosovë.

Cilëve shembuj të praktikave më të mira po u referohen nxënësit?

## Informatat Kthyesë

Kjo letër ka të bëjë me këtë metodë të re të të mësuarit. Në fakt po ecën shumë mirë, edhe ne po argëtohem, çdo orë të lëndës së gjuhës angleze ne bëjmë një metodë të re.

Ne po mundohemi të japim maksimumin në të mësuar, dhe po ecim shumë mirë, në çdo orë mësimi të gjuhës angleze, në fund mësuesi na pyet nëse e kuptuam mësimin dhe nëse e kuptuam ngrisim duart lart.

Ne duam shumë që kjo metodë të funksionojë edhe në lëndë të tjera!

Elda Zejnullahu  
Klasa e gjashtë

## Lënda e gjuhës angleze.

Lënda e gjuhës angleze është sinqerisht më e mira. Uroj që çdo lëndë tjetër të na jepte mësimë ashtu siç bën mësuesi ynë i anglishtes. Çdo fjali përkthehet dhe kjo na ndihmon shumë. Është shumë e rëndësishme për mua të shoh përkthimin e fjalëve që janë të vështira për mua, kështu që me ndihmën e mësuesit tim i di gjërat që nuk i dija në të kaluarën.

Kjo ndihmon edhe studentët e tjerë që e kanë të vështirë të mësojnë anglisht, por tani ata po përmirësohen me kalimin e kohës. Mësuesi ynë tregon gjithashtu qëllimet e mësimin dhe është gjithmonë më e lehtë të dimë se çfarë do të mësojmë dhe bëjmë.

Një gjë që më pëlqen shumë në klasën time të anglishtes është se ne gjithashtu kemi shumë aktivitete dhe të gjitha ato janë të lidhura me anglishten dhe mësimet e anglishtes, dhe në fakt është shumë argëtuese dhe më motivon shumë të vazhdoj dhe të mësoj më shumë dhe më shumë.

Nga: Anita Rexhepi  
Klasa 7/2 "Skender Emerllahu"

Të nxënit digjital





# Idetë e të nxënimit digjital për diferencim

**Hulumtimi në internet:** Përdorimi i hulumtimit në internet dhe i përkthimit online u ofron nxënësve qasje në një bazë të madhe të të dhënave.

Aktivitetet hulumtuese në shkolla kërkojnë filtra të sigurisë.

Mësimdhënësit duhet t'i ndajnë ueb-faqet e përshtatshme për moshën me nxënësit në vend që të lejojnë kërkime plotësisht të hapura.

Mësimdhënësit mund ta bëjnë diferencimin sipas përmbajtjes duke ofruar linqe në ueb-faqe me nivele të ndryshme të ndërlikueshmërisë gjuhësore.

# Idetë e të nxënimit digjital për diferencim

**Softuer për përpunimin e tekstit:** Nxënësit mund ta prezantojnë punën me shkrim duke përdorur programe të përpunimit të tekstit. Nxënësit mund të punojnë në mënyrë bashkëpunuese në dokumente dhe prezantime duke përdorur mjete të bazuara në cloud.

## Diferencimi sipas procesit

Është me rëndësi që mësime nxënës të kuptojnë se procesi i të shkruarit duke përdorur një mjet për përpunimin e tekstit është shumë i ndryshëm nga të shkruarit me dorë.

Mjetet për përpunimin e tekstit mundësojnë që fjalitë dhe paragrafët të riorganizohen dhe korrigjohen lehtësisht.

Puna e prodhuar me dorë kërkon planifikim më të avancuar dhe aftësi organizative për të pasur cilësi të njëjtë.

# Idetë e të nxënit digjital për diferencim

**Prezantimi digjital i mësim-nxënies:** Nxënësit përdorin një numër mjetesh digjitale për ta paraqitur mësim-nxënien e tyre. Rezultati i të nxënit mund të jetë një video, një prezantim, një ueb-faqe, etj.

**Rubrika** e krijuar nga mësimdhënësi u ndihmon nxënësve të fokusohen në përmbajtje si dhe në aftësitë e nevojshme për ta kryer detyrën.

Nxënësit shpesh mësojnë shpejtë që të përdorin mjetet e prezantimit digjital pa ndërhyrjen e mësimdhënësit. Mësimdhënësit nuk duhet të frikësohen nga përdorimi i mjeteve digjitale, sepse ata nuk janë ekspertë digjital.

**Diferencimi sipas produktit**

# Idetë e të nxënit digjital për diferencim

**Modeli i klasës së përzier:** Informatat paraqiten në mënyrë digjitale. Nxënësit shikojnë video/prezantime online të përmbajtjes së njësisë mësimore në pajisje digjitale. Ndërsa nxënësit u përgjigjen pyetjeve ose e kryejnë punën e tyre, mësimitdhënësi vepron si lehtësues.

Diferencimi sipas përmbajtjes, procesit dhe mjedisit mësimor.

# Idetë e të nxënit digjital për diferencim

**Sistemi i menaxhimit të mësim-nxënies:** Mësimdhënësit i ngarkojnë burimet me nivele të ndryshme të vështirësisë në sistemin e menaxhimit të mësim-nxënies (p.sh. Google classroom, Canvas etj.) Nxënësit e zgjedhin një aktivitet që e pasqyron nivelin e tyre. Një pyetje përforcuese mund t'i ndihmojë ata të vendosin se cili burim është më i përshtatshëm.

Diferencimi sipas përmbajtjes, procesit dhe mjedisit mësimor.

Tekstet  
shkollore



# Aktiviteti lidhur me tekstet shkollore

## Shkëmbim në grup

Punoni në çifte ose në grupe.

Analizoni tekstin shkollor që e përdorni më shpesh.

A e inkurajon mësimdhënien reaguese?

Për shembull:

1. A përfshinë ai strategjitë mendo-ndajë në çifte/kthehu nga partneri i juaj?
2. A përmban ai vlerësim paraprak përpara se të fillojnë vlerësimet e temës?
3. A përmban teksti shkollor vlerësime pas zhvillimit të temës që mund të përdoren për qëllime të vlerësimit formativ?
4. A ka teksti shkollor ndonjë shembull të rubrikës që mund ta përdorin mësimdhënësit?
5. A ka teksti shkollor aktivitete të vetë-vlerësimit për nxënësit?

\*Nuk është e thënë t'i përmbajë të gjitha këto.

Si do ta përmirësonit tekstin shkollor?

Si do ta përshtatnit atë për të përfshirë strategji të mësimdhënies reaguese?

Definicioni i  
mësimdhënies dhe  
mësim-nxënies së  
cilësisë së lartë





# Definicioni i mësimdhënies dhe të nxënit me cilësi të lartë

## Aktivitet i bazuar në detyrë

Shikoni definicionin e mësimdhënies dhe mësim-nxënies së cilësisë së lartë në sllajdin vijues.

Punoni në çifte ose në grupe.

Diskutoni definicionin dhe shkruani definicionin e ri të mësimdhënies dhe mësim-nxënies së cilësisë së lartë me mësimdhënie reaguese në thelb.

# Definicioni i mësimdhënies dhe mësim-nxënies së cilësisë së lartë

Mban fokusin e qëndrueshëm në qëllimin e përgjithshëm të kurrikulës.	Vendos detyra dhe zgjedh burime që ndërtohen mbi njohuritë dhe përvojën e mëhershme.	Përforon rregullisht përgjegjësitë ndër-kurrikulare, duke përfshirë shkrim-leximin, numrat dhe kompetencën digjitale, dhe ofron mundësi për t'i praktikuar ato.	Inkurajon fëmijët dhe të rinjtë që të marrin përgjegjësi të shtuar për të nxënëit e tyre.
Inkurajon fëmijët dhe të rinjtë që të marrin përgjegjësi të shtuar për të nxënëit e tyre.	Nxit bashkëpunimin.	Krijon kontekste autentike për të mësuar	Do të thotë aplikon vlerësimin për parimet e të nxënëit.
Lëviz brenda dhe nëpër fusha të të nxënëit dhe përvojës.	Lëviz brenda dhe nëpër fusha të të nxënëit dhe përvojës.	Sfidon të gjithë nxënësit duke i inkurajuar ata ta njohin rëndësinë e përpjekjeve të vazhdueshme në përmbushjen e pritshmërive që janë të larta por të arritshme për ta.	Do të thotë aplikimin e qasjeve të përziera duke përfshirë edhe ato që promovojnë zgjidhjen e problemeve, të menduarit krijues dhe kritik.

# Aktiviteti lidhur me vetë-studimin e shkollës.

Paramendoni që shkolla e juaj do të inspektohet dhe ju duhet ta shkruani një vetë-studim.

Shikoni standardin 3 më poshtë dhe përgjigjuni pyetjeve lidhur me shkollën tuaj. Vendosi se si do të siguroni dëshmi për mendimin tuaj.

## *Standardi 3 Plotësimi i nevojave individuale të nxënësve*

Sa ua mundësojnë mësime nxënësve të gjithë nxënësve të mësojnë me sukses?

Sa mirë janë diferencuar njësitet mësimore për t'i përmbushur nevojat individuale të nxënësve?

Si janë përfshirë nxënësit nxënësit në mësim-nxënien e tyre?

A janë inkurajuar nxënësit që të reflektojnë mbi mënyrën se si ata mësojnë përveç rezultatit të të nxënësve të tyre?

## Përgjigje e sugjeruar

Inspektorët e shkollës do të mbledhin dëshmi nga:

- Dokumentacioni i planifikimit.
- Vëzhgimi i orëve të mësimit
- Bisedat me nxënës, stafin dhe prindërit.
- Pyetësorët e stafit, prindërve dhe nxënësve
- Të dhënat e vlerësimit

Dëshmitë duhet të tregojnë të njëjtat konkluzione.

# Reflektimi

Cilat janë gjërat më të rëndësishme që i keni mësuar sot?

A i keni përmbushur tri kriteret e suksesit apo ju duhet më shumë kohë për t'i përvetësuar informatat?

Kriteret e suksesit

Pjesëmarrësit e punëtorisë do të përshkruajnë se si e aplikojnë mësimdhënien reaguese efektive (vlerësimin formativ të ciklit të shkurtër) në klasa.

Pjesëmarrësit në punëtori do t'i listojnë strategjitë e mësimdhënies reaguese që u mundësojnë mësimdhënësve t'i plotësojnë nevojat individuale të nxënësve.

Pjesëmarrësit në punëtori do të jenë në gjendje t'i planifikojnë strategjitë e mësimdhënies reaguese në orët e tyre të mësimi.

---



Faleminderit!